

The SVP Epic Continued . . .

*Lugina me emrin Shalë
Mu te qafa në të dalë
Qafa që pushonte rrallë
Me "turistë" Amerikanë
Shqiptarë dhe Evropianë
Lart e posht si shtegëtarë
Me foristrada karvanë
Ngarkuar si dhe më parë
Këtë herë shumë kanë ardhë
O sezoni faqebardhë
O stani sipër në majë
Fshatrat e Shalës me radhë
Priti grupet palë palë
Studjuesit margaritarë
Një libër në plan e kanë
Për atë Shalën e parë
Për ç'ka qesh edhe ç'ka qarë
Historitë e trimëritë
Lahutat dhe çiftelitë
Kullat edhe kullanritë
Vallë ç'do dalë në dritë?
Historinë na i thanë
Ishin tre vëllezër bashkë
Skishin shumë e duhej ndarë
I vogli zgjodhi më parë
Pakë bukë e doli larë
Vëllezër u qoft dita e mbarë
I dyti të zgjedhë ju deshë
Mori shoshën që kish mbetë
Për të madhin ngel një shalë
Edhe pse nuk kishte kalë
Lartë portës la nishanë
E kështu të tre u ndanë
Të tre farë fisesh janë
Shalë, Shosh, e Mirditarë . . .*